

V E N D I M
Nr.499, datë 17.10.1994

**PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7699, DATË 21.4.1993 “PËR KOMPENSIMIN
NË VLERË TË ISH-PRONARËVE TË TOKËS BUJQËSORE”**

Në zbatim të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Funksionet e Komitetit Shtetëror të Kompensimit në vlerë të ish pronarëve të tokës bujqësore, siç citohet në nenin 13 të ligjit të sipërpërmendur, do t'i kryejë Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993, kurse funksionet e degëve në rrethe të Komitetit Shtetëror të Kompensimit në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore, siç shihet citohet në nenin 14 të ligjit, do të kryhen nga komisionet për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve që janë ngritur me vendim të këshillave të rretheve, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993.

Në përbërjen e këtyre komisioneve, në zbatim të ligjit, në aparatit e çdo këshilli rrethi për vitin 1994 të shtohen 3 (tre) punonjës dhe 70 mijë lekë fond page, të cilët të jenë me shkëputje nga puna dhe të specialiteteve: agronom i lartë, një inxhinier gjeodet dhe një ekonomist, nga të cilët njëri do të merret nga seksionet e kadastrës. Shtesa e punonjësve dhe fondi përkatës i pagave të përfshihet në planin e buxhetit për vitin 1995.

Personave pjesëmarrës në këto komisione u ruhet vendi i punës për gjithë periudhën e pjesëmarrjes në komision.

Anëtarët që shtohen në komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe, përveç pagës, marrin edhe një shpërblim plotësues mujor në masën 60 për qind të pagës bazë, por jo më shumë se 4000 lekë dhe jo më pak se 2200 lekë në muaj.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.402, datë 1.8.1994, për efekt të shtesës së shpërblimit plotësues mujor për të gjitha komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve pranë bashkive dhe këshillave të rretheve, të shtohen 4,5 milionë lekë.

2. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, në zbatim të ligjit “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, ka këto të drejta dhe detyra:

a) Evidencon pretendimet e ish-pronarëve për probleme që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj.

b) Bën mbledhjen jo më rrallë se një herë në muaj, shqyrton problemet e ngritura dhe harton e i propozon Këshillit të Ministrave akte të reja ose plotësime në aktet ekzistuese ligjore e nënligjore.

c) Bën drejtimin metodik të veprimtarisë së komisioneve, ndjek procesin e kompensimit në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore dhe raporton periodikisht në Këshillin e Ministrave për ecurinë e zbatimit të ligjit.

ç) Jep përgjigje dhe u bën sqarimet përkatëse personave të interesuar për problemet që përmban ligji.

Komiteti e zhvillon veprimtarinë e tij pranë Këshillit të Ministrave.

3. Komisionet kanë këto detyra dhe të drejta:

a) Njohin të drejtën e pronësisë për ish-pronarët e tokës bujqësore, duke lëshuar dokumentin përkatës për njohjen dhe masën e kompensimit të saj.

b) Kontrollonjë vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin kërkuarit dhe e ballafaqojnë me dokumentacionin teknik të zyrës së kadastrës për sasinë e sipërfaqes dhe masën e kompensimit që u takon.

c) Organet financiare në rreth dhe bashki (përkatësisht sipas vendndodhjes së tokës) të ekzekutojnë detyrimet në përputhje me vendimin që ka marrë komisioni.

ç) Kërkuar, për çdo kërkesë të paraqitur komisionit, paguan një tarifë shërbimi në masën 2000 lekë, e cila do të përdoret për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve që bëhen në këtë drejtim.

d) Kërkojnë nga zyrat e kadastrës dhe ato të hipotekës që kanë në evidencë tokën bujqësore, të paraqesin dokumentet që komisioni i gjykon të nevojshme.

dh) Në përputhje me ligjin dhe në bazë të dokumentacionit përkatës, përcaktojnë rastet kur ish-pronarët nuk përfitojnë kompensim në vlerë të tokës bujqësore.

e) Evidencojnë pretendimet e kërkuessve që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj, dhe ia paraqesin ato Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

ë) Komisionet e rretheve mbulojnë veprimtarinë e kompensimit në vlerë të tokave bujqësore jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara si në juridiksionin e këshillave të rretheve, ashtu edhe në juridiksionin e atyre bashkive që administrojnë tokë bujqësore, si dhe rastet e tokave ish-bujqësore që kanë mbetur pa u kompensuar sipas ligjit 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronarve ish-pronarëve”.

4. Ish-pronarët që pretendojnë kompensim në vlerë të tokës bujqësore, në zbatim të nenit 14 të ligjit, duhet të paraqesin në komision, krahas kërkesës me shkrim, edhe këto dokumente:

a) Aktin e pronësisë nga kadastra ose hipoteka. Në mungesë të tyre vendimin e gjykatës që vërteton pronësinë.

b) Aktin e trashëgimisë.

c) Vendimin e dhënë nga komisioni për diferencën e pakompensuar të tokës bujqësore sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

ç) Deklaratë personale për efekt të nenit 12 të ligjit.

d) Dokumentin që vërteton sasinë e tokës së përfutur sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, nga komisioni i ndarjes së tokës, ose dokument negativ kur nuk kanë marrë tokë.

dh) Trashëgimtari i martuar para datës 1.8.1991, krahas dokumenteve të mësipërme, duhet t’i paraqesë komisionit edhe një vërtetim, ku të përcaktohet nëse kryefamiljari i tij (pas martese) ka përfutur ose jo tokë në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”. Sasia e tokës që ka përfutur trashëgimtari në këtë rast do të zbritet në përlllogaritjet e sipërfaqes së tokës bujqësore që do t’i kompensohet. Për këtë qëllim kërkuessi duhet të paraqesë çertifikatën e gjendjes civile, në të cilën të shprehet gjendja familjare në datën 1.8.1991.

e) Komisioni i dërgon periodikisht zyrës së gjendjes gjyqësore pranë Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Kasacionit dhe organeve të pushtetit lokal listën e personave që kanë paraqitur deklaratë për efekt të nenit 12 të ligjit. Nëse nga verifikimi do të vërtetohet e kundërta e asaj që është deklaruar, personit i hiqet e drejta e kompensimit dhe denoncohet për ndjekje penale.

5. Komisioni, pasi pranon kërkesën dhe dokumentet që paraqesin ish-pronarit, i administron ato dhe i regjistron në regjistër të veçantë.

6. Vendimi që merret nga komisioni hartohet në tri kopje, nga të cilat njëra mbetet në dosjen që administron komisioni, një kopje i kalohet organit që kryen likuidimin e kompensimit dhe një kopje ish-pronarit.

7. Ngarkohen këshillat e rretheve që brenda muajit nëntor të vitit 1994, nëpërmjet zyrave të kadastrës, t’u japin komisioneve dokumentacionin kadastral në bazë fshati, ku të jenë përcaktuar kategoritë dhe vendndodhjet e tokave bujqësore, si dhe vendndodhjet e ullishteve, pemëtoreve, vreshtave dhe tokave bujqësore që konsideroheshin si të tilla në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të ndjekë realizimin e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm teknik nga zyrat e kadastrës.

8. Për zbatimin e këtij vendimi, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1994, këshillave të rretheve dhe bashkive u shtohet fondi prej 7 milionë lekësh. Detajimi për çdo këshill rrethi dhe bashki bëhet nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve dhe i jepet Ministrisë së Financave për zbatim.

9. Përcaktimi në vlerë i kompensimit për tokën bujqësore bëhet sipas ligjit nr.7836, datë 22.6.1994 “Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi”.

10. Vendimi i komisionit është i detyrueshëm për zbatim nga organet financiare, sipas përcaktimeve që do të bëjë Ministria e Financave.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve pranë këshillave të rretheve, si dhe organet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

